

Statistikat afatshkurtra

Tremujori IV, 2014

Tiranë, më 27 Mars: INSTAT publikon “Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike”, tremujori i katërt 2014, sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 dhe me bazë të përditësuar, nga 2005 në 2010. Anketa mbulon aktivitetet: *“Industri” (përfshi Industri nxjerrëse dhe Industri përpunuese), “Energji elektrike, gaz, avull”, “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”, “Ndërtim”, dhe “Shërbime” (ku përfshihen Tregti, Transport dhe magazinim, Hotele, Informacioni dhe Komunikimi, Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike, Agjenci udhëtimi). (Shih shënime metodologjike, fq.19).*

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, vlerësuar me çmime fikse (2010=100) arriti 128,9 % në tremujorin e katërt 2014.

Ndryshimi vjetor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum pasqyron në aktivitetet ekonomike të mbuluara në anketë, rritje prej 2,6 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2013. Ky ndryshim në të njëjtin tremujor të vitit 2013 ishte me rritje 4,4 %. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet që kryhen në sektorët *“Energji elektrike, gaz, avull”, “Ndërtim” dhe “Hotele”, përkatësisht me 30,6 %, 19,3 %, 19,8 %*. Në aktivitetin *“Industri” kemi rënie 4 %, ku rënien më të madhe e dha dega “Industri Nxjerrëse” me 16,2 %*.

Shifra e afarizmit në volum, në *“Shërbime”, në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ka rënë me 1,4 %, ndikuar kryesisht nga aktivitetet: “Informacioni dhe Komunikacioni” dhe “Transport dhe Magazinim”*.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e katërt 2014, paraqitet me rritje prej 2 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2014. Në këtë rritje ndikojnë aktivitetet që kryhen në sektorët, *“Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Ndërtim” përkatësisht me 25,8 %, 24,6 %*. Në aktivitetin *“Industri”, kemi rënie 6,5 %, ku dega me rënien më të lartë është “Industria Nxjerrëse” me 13,6 %*. Në krahasim me tremujorin e tretë 2014, në aktivitetet *“Shërbime” kemi rënie 1,6 %, rënien e shifrës së afarizmit në volum, e kanë dhënë aktivitetet si “Hotele” 10,9 % dhe “Transport dhe Magazinim” 8,3 %*.

Fig.1 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum





Fig.2 Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në Industri, Ndërtim dhe Shërbime



Tab. 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	IV - 13 IV - 12	I - 14 I - 13	II - 14 II - 13	III - 14 III - 13	IV - 14 IV - 13
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	4,4	3,8	2,8	8,2	2,6
B+C	Industri	11,4	8,9	8,6	9,0	-4,0
B	Industri nxjerrëse	68,4	22,1	22,9	19,1	-16,2
C	Industri përpunuese	-1,4	4,6	3,7	5,7	0,8
D	Energji elektrike, gaz, avull	13,8	-3,1	3,7	14,4	30,6
E	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	40,0	-4,2	7,7	-5,7	-6,2
F	Ndërtim	-9,3	2,1	-11,6	16,2	19,3
G - N	Shërbime	4,3	4,1	4,5	5,4	-1,4
G	Tregti	5,8	6,7	6,2	7,8	0,4
H (49-53)	Transport dhe magazinim	-22,9	-47,8	-43,3	-44,6	-15,0*
I (551)	Hotele	-22,0	-4,7	16,3	24,8	19,8
J (58-62)	Informacioni dhe komunikimi	4,5	8,8	19,2	11,8	-23,1
M (71)	Aktivitetet arkitekture dhe inxhinierike	20,2	16,3	-12,4	14,1	56,2
N (79)	Agjenci udhëtimi	41,4	30,6	37,0	35,5	17,1

Tab. 2 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum, sipas aktivitetit ekonomik

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Përshkrimi	IV - 13 III - 13	I - 14 IV - 13	II - 14 I - 14	III - 14 II - 14	IV - 14 III - 14
	Aktivitetet ekonomike gjithsej	7,5	-17,5	11,4	9,4	2,0
B+C	Industri	6,2	-12,4	13,2	3,6	-6,5
B	Industri nxjerrëse	22,8	-15,7	17,4	-2,1	-13,6
C	Industri përpunuese	0,9	-11,3	11,5	5,9	-3,8
D	Energji elektrike, gaz, avull	10,2	13,3	0,4	-8,8	25,8
E	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	1,5	-13,1	8,2	-1,1	1,0
F	Ndërtim	21,4	-24,0	20,4	4,7	24,6
G - N	Shërbime	5,2	-20,8	10,4	14,6	-1,6
G	Tregti	6,1	-20,3	11,7	14,1	-1,2
H (49-53)	Transport dhe magazinim	-40,2	-36,4	19,6	21,7	-8,3*
I (551)	Hotele	-7,2	-16,6	39,1	15,8	-10,9
J (58-62)	Informacion dhe komunikim	34,1	-26,6	-1,0	14,7	-7,7
M (71)	Aktivitetet arkitekture dhe inxhinierike	-7,2	15,1	-16,1	27,3	27,0
N (79)	Agjenci udhëtimi	14,2	-14,9	19,7	16,6	-1,4

*Struktura e aktiviteteve të transporti ka ndryshuar në mes të tremujorit të katërt 2013, për arsye metodologjike ndryshimet e indekseve do të reflektohen në tremujorin e parë 2015.

Industri, Energji dhe Ujë

Në tremujorin e katërt 2014, **në ndryshim vjetor**, indeksi i shifrës së afarizmit në volum në aktivitetin “Industri” (përfshirë Industrinë nxjerrëse dhe përpunuese) ka rënë 4 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013. Ndikimin kryesor e dha aktiviteti “Industri nxjerrëse” me një rënie prej 16,2 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, aktiviteti “Energji elektrike, gaz, avull” paraqitet me rritje 30,6 %, ndërsa aktiviteti “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve” me rënie 6,2 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “Industri”, paraqitet me rënie 6,5 %. Në këtë rënie ndikoi kryesisht aktiviteti “Industri nxjerrëse” me 13,6 %.

Aktivitetet “Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve” shënuan rritje përkatësisht me 25,8 % dhe 1 %.

Krahasuar me tremujorin e katërt 2013, **në ndryshim vjetor**, volumi i prodhimit industrial në “Industri” shënoi një rënie prej 7,2 %. Ndikimin kryesor e dha aktiviteti “Industri nxjerrëse” me një rënie prej 21,9 %.

Ndërsa, aktivitetet “Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve” shënuan rritje përkatësisht me 19 % dhe 2,2 %.

Gjatë tremujorit të katërt 2014, **në ndryshim tremujor**, volumi i prodhimit industrial shënoi një rënie me 9 % krahasuar me tremujorin paraardhës, ku ndikimin më të madh e ka dhënë “Industria nxjerrëse” me 18,6 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimore, volumi i prodhimit në “Energji elektrike, gaz, avull” dhe “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve” shënoi një rritje përkatësisht me 48,6 % dhe 0,4 %.

Gjatë tremujorit të katërt 2014, **në ndryshim vjetor**, numri i të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet që operojnë në aktivitetin “Industri” (Industri nxjerrëse dhe përpunuese) u rrit me 16,7 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në “Industri përpunuese” me 17,3 %.

Për aktivitetin “Energji elektrike, gaz, avull” ky tregues paraqitet me rritje 9,3 % ndërsa për aktivitetin “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”, paraqitet me rënie 2,2 %.

Me një rënie prej 0,5 % rezulton **në ndryshim tremujor**, numri i të punësuarve me pagesë në ndërmarrjet e aktivitetit “Industri”, rënie e cila vjen nga ndikimi i aktiviteteve “Industri përpunuese” dhe “Industri nxjerrëse” përkatësisht me 0,5 % dhe 0,4 %.

Ky tregues paraqitet me rritje 1,8 % në aktivitetin “Energji elektrike, gaz, avull” dhe rënie 2,7 % në aktivitetin “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”.

Gjatë tremujorit të katërt 2014, niveli i fondit të pagave, **në ndryshim vjetor**, shënoi një rritje prej 13,1 % në “Industri”, ndryshim i cili vjen kryesisht nga rritja e këtij treguesi në “Industri përpunuese” me 15,9 %.

Në aktivitetin “Energji elektrike, gaz, avull” ky tregues u rrit me 14,9 % ndërsa në aktivitetin “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”, shënoi një rënie me 8,8 %.

Fondi i pagave, **në ndryshim tremujor**, shënoi rritje me 2,5 % në aktivitetin “Industri”, rritje e cila vjen kryesisht nga ndikimi i aktivitetit “Industri nxjerrëse” me 3,5 %.

Ky tregues shënoi rritje në aktivitetin “Energji elektrike, gaz, avull” me 3,1 %, ndërsa në aktivitetin “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”, rënie 1,6 %.

Fig. 3 Indeksi i shifrës së afarizmit dhe prodhimit industrial në Industri (nxjerrëse dhe përpunuese)

(2010=100)

(%)




Fig. 4 Indeksi i shifrës së afarizmit në Industri nxjerrëse, Industri përpunuese, Energji Elektrike dhe Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve





Fig. 5 Sasia e prodhimit të Energjisë elektrike në (000/kw-orë)



Tab. 3 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
			IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	11,4	8,9	8,6	9,0	-4,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	68,4	22,1	22,9	19,1	-16,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	-1,4	4,6	3,7	5,7	0,8
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	13,8	-3,1	3,7	14,4	30,6
E	36-39	<i>Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve</i>	40,0	-4,2	7,7	-5,7	-6,2

Tab. 4 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
			III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
B-C	05-33	Industri	6,2	-12,4	13,2	3,6	-6,5
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	22,8	-15,7	17,4	-2,1	-13,6
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	0,9	-11,3	11,5	5,9	-3,8
D	35	Energji elektrike, gaz, avull	10,2	13,3	0,4	-8,8	25,8
E	36-39	<i>Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve</i>	1,5	-13,1	8,2	-1,1	1,0

Tab. 5 Ndryshimi vjetor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
			IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	25,5	19,1	-0,2	4,8	-7,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	57,1	17,6	-1,2	8,2	-21,9
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	-0,4	18,9	-0,1	1,3	10,2
D	35	Energji elektrike, gaz, avull*
E	36-39	<i>Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve</i>	6,8	-6,7	19,5	-11,4	2,2

*Informacioni mbi prodhimin e energjisë elektrike në proces vlerësimi

Tab. 6 Ndryshimi tremujor i Indeksit të volumit të prodhimit industrial në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV -14
			III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
B-C	05-33	Industri	2,8	1,1	-6,5	7,9	-9,0
B	05-09	Industri nxjerrëse	12,9	-10,9	-4,6	12,7	-18,6
C	10-33	Industri përpunuese	-8,5	15,9	-8,1	4,0	-0,5
D	35	Energji elektrike, gaz, avull
E	36-39	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	-12,9	-23,0	30,8	1,1	0,4

*Informacioni mbi prodhimin e energjisë elektrike në proces vlerësimi

Tab. 7 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
			IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	10,2	15,8	21,4	20,7	16,7
B	05-09	Industri nxjerrëse	17,9	2,9	-0,6	10,1	12,8
C	10-33	Industri përpunuese	8,9	17,9	25,4	22,6	17,3
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	12,0	10,6	8,8	6,4	9,3
E	36-39	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	14,8	1,9	5,8	1,6	-2,2

Tab. 8 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV -14
			III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
B-C	05-33	Industri	2,9	13,5	2,9	0,4	-0,5
B	05-09	Industri nxjerrëse	-2,7	3,1	0,4	9,4	-0,4
C	10-33	Industri përpunuese	4,0	15,1	3,3	-0,9	-0,5
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	-0,9	7,9	0,6	-1,1	1,8
E	36-39	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	1,0	-0,6	2,0	-0,8	-2,7

Tab. 9 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
			IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
B-C	05-33	Industri	30,3	17,4	22,3	19,8	13,1
B	05-09	Industri nxjerrëse	69,1	15,4	20,4	21,1	9,3
C	10-33	Industri përpunuese	13,1	17,6	22,9	19,1	15,9
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	14,5	23,8	24,3	13,1	14,9
E	36-39	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	33,0	-5,8	5,9	7,9	-8,8

Tab. 10 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Industri, Energji dhe Ujë

(2010=100)

(%)

Seksioni	NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
			III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
B-C	05-33	Industri	8,5	2,4	5,6	2,0	2,5
B	05-09	Industri nxjerrëse	14,6	-10,1	9,3	7,5	3,5
C	10-33	Industri përpunuese	4,8	9,9	4,0	-0,5	2,0
D	35	Energjia elektrike, gaz, avull	1,6	8,1	6,1	-2,9	3,1
E	36-39	Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve	16,5	-10,2	10,2	-6,4	-1,6

Ndërtimi

Në aktivitetin e “Ndërtimit”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e katërt 2014 shënoi një rritje prej 19,3 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndërkaq volumi i ndërtimit paraqitet me një rritje prej 21,1 %.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin e Ndërtimit në tremujorin e katërt 2014 paraqitet me një rritje prej 24,7 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, fondi i pagave shënoi një rritje prej 16,3 % gjatë së njëjtës periudhë.


Në tremujorin e katërt 2014, **ndryshmi tremujor** i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, shënoi një rritje prej 24,6 % krahasuar me tremujorin e tretë 2014, ndërkaq volumi i ndërtimit është rritur me 23,5 % gjatë së njëjtës periudhë.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin e “Ndërtimit” në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2014, paraqitet me rritje prej 3,6 %, ndërkaq fondi i pagave shënoi një rritje prej 7,2 %.

Fig. 6 Indekset e shifrës së afarizmit dhe volumit të ndërtimit

(2010=100)

(%)



Tab. 11 Ndryshimi vjetor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(2010=100) (%)


NVE Rev.2	Treguesit	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
		IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
41-43	Shifra e afarizmit	-9,3	2,1	-11,6	16,2	19,3
	Volumi i ndërtimit	-10,1	1,3	-14,7	13,8	21,1
	Të punësuar me pagesë	2,0	8,5	15,6	20,7	24,7
	Fondi i pagave	20,5	0,5	9,7	3,8	16,3

Tab. 12 Ndryshimi tremujor i Indekseve të treguesve në Ndërtim

(2010=100) (%)

NVE Rev.2	Treguesit	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
		III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
41-43	Shifra e afarizmit	21,4	-24,0	20,4	4,7	24,6
	Volumi i ndërtimit	16,0	-26,3	22,0	9,2	23,5
	Të punësuar me pagesë	0,2	14,5	0,3	4,9	3,6
	Fondi i pagave	-4,3	3,8	1,0	3,4	7,2

Fig. 7 Indeksi i volumit të ndërtimit në Ndërtime të reja, Rikonstruksione dhe Punime inxhinierike



Shërbime

Në tremujorin e katërt 2014, **në ndryshim vjetor**, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetin “Shërbime” është ulur 1,4 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013. Në këtë ulje ndikojnë aktivitetet: “Informacioni dhe komunikacioni” dhe “Transport dhe magazinim”. Në aktivitetet “Transport dhe magazinim”, ku përfshihet dhe aktiviteti “Postë”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013, paraqitet me rënie prej 15,0 %.

Në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2014, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet e “Shërbimeve” është ulur 1,6 %. Në këtë ulje ndikojnë aktivitetet: “Transport dhe magazinim” me 8,3 %, “Tregti me shumicë” me 2,2 % “Agjenci udhëtimi” me 1,4 %, etj. Në “Aktivitete të arkitekturës dhe inxhinierike”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, paraqitet me rritje prej 27 % në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e tretë 2014.

Në tremujorin e katërt 2014, **në ndryshim vjetor**, në aktivitetin “Shërbime” ka pasur një rritje të numrit të të punësuarve me pagesë me 12,8 %. Kontributin në këtë rritje e kanë dhënë aktivitetet “Hotele” me 26,5 % dhe “Tregti me shumicë” me 15,1 %, etj.

Në tremujorin e katërt 2014, **në ndryshim tremujor**, në ndërmarrjet e aktivitetit “Shërbime” ka pasur rritje të numrit të të punësuarve me pagesë me 0,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2014. Në këtë rritje kanë ndikuar aktivitetet “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike” me 9,2 %, “Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi automjeteve dhe motoçikletave” me 7,3 %. Ndërsa, aktiviteti “Hotele” paraqitet me rënie 6,6 % në këtë tregues.

Në aktivitetin “ Shërbime”, **në ndryshim vjetor**, në tremujorin e katërt 2014, ka patur një rritje të fondit të pagave me 6,3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kontribut kryesor në rritje në këtë tregues kanë dhënë aktivitetet “Hotele” me 23,4 %, “Tregti me shumicë” me 16,7 %, “Informacioni dhe komunikacioni” me 12,3 %, etj.

Në aktivitetin “ Shërbime”, në tremujorin e katërt 2014, **në ndryshim tremujor**, fondi i pagave paraqitet me rritje 1,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2014. Në këtë rritje kanë ndikuar aktivitetet “Informacioni dhe komunikacioni” me 16,9 %, “Agjenci udhëtimi” me 8,4% “Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave” me 5,3 %.

Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregtia me shumicë

Indeksi i shifrës së afarizmit në volum, **në ndryshim vjetor**, në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013, në aktivitetet “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” dhe “Tregti me shumicë” është rritur me 10,5 % dhe ulur me 0,8 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” dhe “Tregti me shumicë” është ulur përkatësisht me 0,5 % dhe 2,2 %, në tremujorin e katërt 2014 në krahasim me tremujorin tretë 2014.

Në tremujorin e katërt 2014, në ndërmarrjet e aktivitetit “Tregti me shumicë”, **ndryshimi vjetor** i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë paraqet rritje 15,1 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Ndërsa, **në ndryshim tremujor**, ky tregues paraqet rritje 0,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2014.

Në aktivitetin “Tregti me shumicë”, **në ndryshim vjetor**, në tremujorin e katërt 2014, ka patur një rritje të fondit të pagave me 16,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa në aktivitetin “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” ka patur rënie me 1,2 %.

Në ndryshim tremujor, ky tregues paraqet rënie 0,4 % në aktivitetin “Tregti me shumicë”, ndërsa në aktivitetin “Tregti me pakicë dhe shumicë e automjeteve dhe riparimi i automjeteve” ka patur rritje me 5,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2014.

Transporti dhe Magazিনি (përfshirë dhe aktiviteti “Postë”)

Në aktivitetet “Transporti dhe magazinimi”, ku përfshihet dhe aktiviteti “Postë”, shifra e afarizmit në volum, ka pësuar rënie me 15 %, në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013, si rezultat i ndikimit negativ të aktivitetit “Transport ajror”. Në aktivitetin postë, indeksi i shifrës së afarizmit në volum krahasuar me tremujorin e katërt 2013 paraqet rritje 6,5 %.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, në aktivitetet “Transport dhe magazinim”, përfshirë dhe aktivitetin “Postë”, është ulur 8,3 %. Në aktivitetin postë, indeksi i shifrës së afarizmit në volum krahasuar me tremujorin e tretë 2014 paraqet rritje 12,9 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Transport dhe magazinim” paraqet rritje me 4,6 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Ndërsa, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin e “Transport dhe magazinim” **ndryshimi tremujor**, është 0 % krahasuar me tremujorin e tretë 2014.

Referuar të njëjtit aktivitet, **në ndryshim vjetor**, indeksi i fondit të pagave paraqitet me rënie 22,2 %.

Krahasuar me tremujorin e tretë 2014, indeksi i fondit të pagave paraqet rënie 17,1 %, në aktivitetin “Transport dhe magazinim”.

Hotele

Në aktivitetin “ Hotele”, **në ndryshim vjetor**, shifra e afarizmit në volum, rritet 19,8 % në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Në tremujorin e katërt 2014, në aktivitetin “Hotele”, krahasuar me tremujorin e tretë 2014, indeksi i shifrës së afarizmit në volum paraqet ulje 10,9 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në tremujorin e katërt 2014 paraqet rritje 26,5 %, ndërkaq në **ndryshim tremujor**, krahasuar me tremujorin e tretë 2014, ky tregues paraqet ulje 6,6 %.

Fondi pagave, **në ndryshim vjetor**, në ndërmarrjet e aktivitetit “Hotele” paraqitet me rritje 23,4 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndërkohë që në **ndryshim tremujor**, krahasuar me tremujorin e tretë 2014, ky tregues paraqet rënie 5,5 %.

Informacioni dhe Komunikacioni

Në aktivitetin “Informacioni dhe Komunikacioni”, indeksi i shifrës së afarizmit në volum, është ulur 23,1 % në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum në aktivitetet “Informacioni dhe Komunikacioni”, paraqitet me rënie 7,7 % krahasuar me tremujorin e tretë 2014.

Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë, në aktivitetin “Informacioni dhe Komunikacioni”, në **ndryshim vjetor**, paraqitet me rritje 4,4 %, në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Ndryshimi tremujor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë referuar të njëjtit aktivitet “Informacioni dhe komunikacioni” paraqitet me ulje 4,4 %.

Fondi i pagave në aktivitetin “Informacioni dhe komunikacioni”, paraqitet me rritje 12,3 %, ndërsa ndryshimi tremujor i indeksit të fondit të pagave paraqet rritje 16,9 %.

Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike

Indeksi i shifrës së afarizmit në volum në “Aktivitete të Arkitekturës dhe Inxhinierike” rritet 56,2 % në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rritje me 27 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike” paraqet rritje 3,8 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndërsa në **ndryshim tremujor**, referuar të njëjtit aktivitet, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë paraqitet me rritje 9,2 %.

Ndryshimi vjetor i indeksit të fondit të pagave në aktivitetin “Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike” paraqet rënie 9,6 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Me rritje 3,9 % paraqitet indeksi i fondit të pagave në këtë tremujor, referuar të njëjtit aktivitet, krahasuar me tremujorin e tretë 2014.

Agjencitë e udhëtimit

Në aktivitetin “Agjenci e udhëtimi”, shifra e afarizmit në volum, rritet 17,1 % në tremujorin e katërt 2014 krahasuar me tremujorin e katërt 2013.

Ndryshimi tremujor i indeksit të shifrës së afarizmit në volum, paraqet rënie 1,4 % krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor i indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në aktivitetin “Agjenci udhëtimi” paraqet rritje 1,2 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndërsa **në ndryshim tremujor**, indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë në këtë aktivitet paraqet rritje 0,9 %.

Indeksi i fondit të pagave, **në ndryshim vjetor**, në aktivitetin “Agjenci udhëtimi” paraqet rënie 5,7 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013, ndërsa **në ndryshim tremujor**, ky tregues paraqitet me rritje 8,4 %.

Tab. 13 Ndryshimi vjetor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
NVE Rev.2		IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
G-N	Shërbime	4,3	4,1	4,5	5,4	-1,4
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	-3,1	-2,7	0,0	8,3	10,5
G(46)	Tregtia me shumicë	7,2	7,1	6,5	8,0	-0,8
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-22,9	-47,8	-43,3	-44,6	-15,0
I(5500)	Hotele	-22,0	-4,7	16,3	24,8	19,8
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	4,5	8,8	19,2	11,8	-23,1
M(71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	20,2	16,3	-12,4	14,1	56,2
N(79)	Agjenci udhëtimi	41,4	30,6	37,0	35,5	17,1

Tab. 14 Ndryshimi tremujor i Indeksit të shifrës së afarizmit në volum në Shërbime

(2010=100)


(%)

Kodi	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV -14
NVE Rev.2		III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
G-N	Shërbime	5,2	-20,8	10,4	14,6	-1,6
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	-2,5	-3,6	5,7	9,0	-0,5
G(46)	Tregtia me shumicë	6,5	-23,1	13,5	16,2	-2,2
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-40,2	-36,4	19,6	21,7	-8,3
I(5500)	Hotele	-7,2	-16,6	39,1	15,8	-10,9
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	34,1	-26,6	-1,0	14,7	-7,7
M(71)	Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike	-7,2	15,1	-16,1	27,3	27,0
N(79)	Agjenci udhëtimi	14,2	-14,9	19,7	16,6	-1,4

Fig. 8 Indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë dhe fondi i pagave, në Shërbime

(2010=100)

(%)



Tab. 15 Ndryshimi vjetor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
		IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
G-N	Shërbime	8,2	7,6	18,1	15,2	12,8
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	6,1	9,8	17,4	3,9	10,5
G(46)	Tregtia me shumicë	11,6	9,5	12,8	17,6	15,1
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-4,4	-4,8	-4,3	-2,9	4,6
I(5500)	Hotele	4,5	6,6	20,9	22,0	26,5
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	-19,8	-12,1	13,0	19,8	4,4
M(71)	Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike	82,1	22,7	37,7	21,6	3,8
N(79)	Agjenci udhëtimi	30,3	0,7	2,7	-1,5	1,2

Tab. 16 Ndryshimi tremujor i Indeksit të numrit të të punësuarve me pagesë në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
------	---------------------	---------	--------	---------	----------	---------

NVE Rev.2		III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
G-N	Shërbime	2,5	9,5	6,2	-3,4	0,4
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	0,9	6,2	9,9	-11,8	7,3
G(46)	Tregtia me shumicë	2,4	9,1	1,2	4,1	0,1
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-7,1	3,1	0,3	1,2	0,0
I(5500)	Hotele	-9,9	12,5	7,4	12,1	-6,6
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	9,7	6,5	3,0	-0,5	-4,4
M(71)	Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike	27,9	0,4	5,1	-10,0	9,2
N(79)	Agjenci udhëtimi	-1,7	1,9	-3,5	2,0	0,9

Tab. 17 Ndryshimi vjetor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
		IV - 12	I - 13	II - 13	III - 13	IV - 13
G-N	Shërbime	10,7	3,2	11,0	9,1	6,3
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	13,5	5,3	7,9	-2,7	-1,2
G(46)	Tregtia me shumicë	14,6	4,2	14,9	18,0	16,7
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-11,6	-21,2	-13,7	-23,4	-22,2
I(5500)	Hotele	10,7	8,0	16,7	20,6	23,4
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	0,5	12,0	17,7	23,7	12,3
M(71)	Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike	71,1	6,8	14,7	13,7	-9,6
N(79)	Agjenci udhëtimi	53,4	-11,3	-10,1	-10,0	-5,7

Tab. 18 Ndryshimi tremujor i Indeksit të fondit të pagave në Shërbime

(2010=100)

(%)

Kodi NVE Rev.2	Aktiviteti ekonomik	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14	IV - 14
		III - 13	IV - 13	I - 14	II - 14	III - 14
G-N	Shërbime	4,3	5,8	3,0	-4,1	1,7
G(45)	Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	3,7	-3,7	6,1	-8,1	5,3
G(46)	Tregtia me shumicë	0,7	10,6	5,3	0,6	-0,4
H(49-53)	Transport dhe magazinim	-18,4	-4,9	4,2	-5,3	-17,1
I(5500)	Hotele	-7,6	9,5	5,6	12,9	-5,5
J(58, 61, 62)	Informacioni dhe komunikacioni	28,6	9,7	-6,5	-6,3	16,9
M(71)	Aktivitetet arkitekturore dhe inxhinierike	30,7	-8,3	-5,3	0,2	3,9
N(79)	Agjenci udhëtimi	3,5	-14,5	-0,2	2,0	8,4

Metodologjia

Informacion

INSTAT si rrjedhojë e detyrimeve që ka ndaj Eurostat, për përshtatshmëri të plotë të statistikave shqiptare me ato të vendeve Europiane, publikon indekset e treguesve ekonomike si Shifër afarizmi, Prodhim, Numri i të punësuarve me pagesë dhe Paga për aktivitetet Industri, (ku përfshihen Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, gaz, avull; Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve; Ndërtim dhe Shërbime, ku përfshihen (Tregti; Transport dhe magazinim; Hotele; Informacioni dhe komunikacioni; Aktivitete arkitekture dhe inxhinierike dhe Agjenci udhëtimi).

Në Tregti, anketa mbulon aktivitetet Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe Tregti me shumicë. Treguesit e Tregtisë me pakicë publikohen më vete. Për më shumë informacion, linku: <http://www.instat.gov.al/al/themes/informacioni-ekonomik-për-ndërmarrjet/publication/books/2014/tregtia-me-pakicë,-t3-2014.aspx>;

Ndryshimet metodologjike i referohen:

- Aplikimit të Nomenklaturës së rishikuar të aktiviteteve ekonomike, NVE Rev.2;
- Ri-peshimit, përditësohen peshat e përfaqësimit, nga ASN 2005 në ASN 2010 deri në vitin 2013. Sipas rekomandimeve të Eurostat-it dhe asistencës Suedeze është bërë përditësimi i peshava për vitin 2014 duke përdorur peshat ASN 2012, sipas metodës Chain-link.
- Ri-referimit, përditësohet periudha referuese nga 2005=100 në 2010=100;

Aplikimi i Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2, bëhet me akt ligjor të miratuar me VKM Nr 320 datë 28.05.2014.

Për më shumë shikoni linkun: http://www.instat.gov.al/media/248316/njoftim_per_media_-_ndryshimi_i_nomenklatur_s_s_veprimtarive_ekonomike_rev_2.pdf

Klasifikimi i rishikuar është në mënyrë të konsiderueshme i ndryshëm nga klasifikimi ekzistues në drejtim të strukturës, klasifikimit dhe trajtimit metodologjik të disa aktiviteteve.

Kalimi i njësive statistikore nga NVE Rev.1.1 në NVE Rev.2 është bërë nëpërmjet ndërtimit të matricës së konvertuar, bazuar në informacionin statistikor të përftuar nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2010.

Referuar pikërisht kësaj matrice, disa nga grup-aktivitetet që janë publikuar me NVE Rev.1.1 përgjithësisht kalojnë 100 përqind në grup aktivite publikimi në NVE Rev.2. Ndryshimet që kryesisht sjellë klasifikimi i ri për aktivitetet përbërëse të fushës së mbulimit të ATN, janë si më poshtë:

- a. Sipas klasifikimit të vjetër (NVE Rev. 1) aktivitetet e “Publikimit” përkojnë me ndarjen 22. Në klasifikimin e ri (NVE Rev. 2) “Aktivite publikimi” përkon me ndarjen 58, seksioni J, “Informacioni dhe Komunikacioni”.
- b. Ndarja 45, që përkon me NVE Rev.1.1 në aktivitetin e “Ndërtimit”, detajohet në tre ndarje në klasifikimin e ri, në 41, “Ndërtimi i ndërtesave”, 42, “Punime inxhinierike” dhe 43 “Punime të specializuara ndërtimi”. Pjesë e ndarjes 41 bëhet edhe grupi 70.1 që përkon në NVE Rev.1.1, me aktivitetin “Aktivite mbi pasuritë e patundshme”.
- c. Aktivitetet e postave dhe korrierës, që përkon në NVE Rev. 1.1, me klasat 64.11 dhe 64.12, kalon në aktivitetin “Transport dhe magazinim”, që përkon në NVE Rev.2 me ndarjen 58, “Aktiviteti i postës dhe korrierës”.
- d. Një tjetër risi e klasifikimit të ri, me ndikim në publikimin e indeksit të statistikave afatshkurtra (tremujore) është edhe ardhja në fushën e mbulimit të aktiviteve si: “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”, që përkon me klasifikimin NVE Rev.1.1, ndarja 90. Në klasifikimin e ri, NVE Rev.2, këto aktivite i përkojnë ndarjes 38, “Grumbullimi, furnizimi me ujë dhe trajtimi i mbetjeve”. Bëhet pjesë e kësaj ndarje edhe grupi 38.3, që përkon në NVE Rev.1.1, me ndarjen 37, “Riciklimi”.
- e. Në grupin 71.00, që përkon në NVE Rev.2, me “Aktivite arkitekture dhe inxhinierike, aktivite të kontrolleve dhe analizave teknike”, përfshihen edhe aktivite të veçanta të grupeve 74.3 -74.8, që përkon me NVE Rev.1.1 me “Aktivite të kontrollit dhe analiza teknike”.

Treguesi kryesor i shifrës së afarizmit është përdorur për rivlerësimin e kalimit të aktiviteve ekonomike nga nomenkatura e vjetër në nomenklaturën e re. Metodave kryesore të përdorura për vlerësim janë dy:

- Metoda e vlerësimit në nivel mikro
- Metoda e vlerësimit në nivel makro

Metoda e parë, u përdor për tre vitet e para të riklasifikimit të aktiviteve të njëjësive në nivel individual në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve, 2010-2012;

Metoda e dytë, u përdor për rivlerësimin e të dhënave në seri kohore pas, për periudhën 2005-2010.

Ri-peshimi – për reflektuar ndryshimet e strukturës së ekonomisë, peshat përditësohen, sipas metodologjisë së statistikave europiane sipas aktiviteve përfaqësuese, nga 2005 në 2010.

Ri –referim - shprehimisht do të thotë kalimi i indekseve me një periudhë referuese të re, nga 2005=100 në 2010=100. Seritë e të dhënave, të llogaritura me të dy periudhat, janë ekuivalente me njëra-tjetrën: ritmet e rritjes janë të njëjta, dhe një seri mund të konvertohet tek tjetra.

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor, në Anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike (35)
- Grumbullim, trajtim dhe furnizim me ujë (36)
- Ndërtim (41, 42, 43)

Shërbime, të cilat përbëhen nga Tregtia me shumicë, Hotele, Transport dhe Magazinim, Agjenci udhëtimi, Komunikacion dhe Informacion dhe shërbime të tjera:

- Tregti me pakicë dhe shumicë, dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (45) dhe Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave (46)
- Transporti dhe Magazinimi (përfshirë edhe Aktiviteti Postar dhe korrierës) (49-53)
- Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor, përfshi vetëm Hotele (55.1)
- Informacioni dhe Komunikacioni (58, 61, 62)
- Aktivitete të arkitekturës dhe Inxhinierike (71)

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2010=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për aktivitetin hotelier, si dhe Shitjen dhe riparimin e automjeteve. Për aktivitetet e transportit përdoret deflator i llogaritur në mënyrë implicite nga të dhënat administrative. Indekset nuk janë të vlerësuara sezonalisht.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur , etj.

Përkufizimet e treguesve kryesorë

Shifra e afarizmit - Shifra e afarizmit përfshin shumat faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

Indeksi i Shifrës së afarizmit - Objektivi i indeksit të shifrës së afarizmit është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

Numri i të punësuarve me pagesë - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

Indeksi i Numrit të punësuarve me pagesë - Paraqet ecurinë e punësimit në njësitë e vrojtuar.

Paga dhe trajtime - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

Indeksi i fondit të pagave - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.